




---

**RAPORTI I KATËRT NGA  
MONITORIMI I INFORMIMIT  
MEDIATIK PËR PUNËN E KUVENDIT**

---



**KUVENDI NËN THJERRËZ**

**Përforcimi i debatit politik  
dhe diskursit deliberativ**

**DHJETOR 2014**



## **RAPORTI I KATËRT NGA MONITORIMI I RAPORTIMIT MEDIATIK PËR PUNËN E KUVENDIT**

**(DHJETOR 2015)**

Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB), duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 e përcjellin nivelin e cilësisë së debatit në Kuvendin dhe raportimin e medieve nga puna e deputetëve. Monitorimi zhvillohet në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” financiarisht i përkrahur nga Unioni Evropian. Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin mediatic. Para jush është raporti i dytë i cili ka të bëjë me raportimin e 10 medieve kombëtare në periudhën nga 1 – 31 dhjetor i vitit 2014.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike të arrihet në njohuri se në çfarë masë janë mediet pjesë e procesit të deliberacionit në shoqërinë gjatë krijimit të politikave publike, përkatësisht në çfarë masë opinionit më të gjerë ja transmetojnë argumentet e prezantuara në diskutimet kuvendore.

Pas çdo muaji të monitoruar opinionit do të informohet përmes raporteve për gjetjet kyçe të monitorimit të medieve edhe nga debati në Kuvendin.

### **A. REZYME**

Gjetja kyçe në raportin e katërt nga monitorimi i raportimit mediatic është se në periudhën e vëzhguar, nga 1 deri më 31 dhjetor, mediet e rritën raportimin nga debatet kuvendore krahasuar me nëntorin dhe tetorin. Vetëm në periudhën 19 qershor – 30 shtator mediet u kanë kushtuar vëmendje pak më të madhe diskutimeve, argumenteve dhe pozicioneve të deputetëve. Me këtë rast, interes më të madh zgjuan procedura për marrje të mandateve të deputetëve opozitar dhe debati rreth ndryshimet e Ligjit për arsim të lartë.

Mediet në dhjetor botuan diç më tepër informacione në të cilat si burim janë theksuar deputetët nga vetëm një opsion politik sesa informacionet në të cilat njëkohësisht janë theksuar deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita. Mirëpo, përqindja e informacioneve të tilla është më e vogël deri tani që nga fillimi i monitorimit. Në llogari të kësaj, u rrit në nivel më të madh deri tani përqindja e informacioneve në të njëkohësisht si burime janë theksuar deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita.

Si burim i informacioneve, në lidhje me Kuvendin, më shpesh paraqiten deputetë. Pjesëmarrja e tyre në dhjetor është rritur dyfish në raport me nëntorin dhe është në nivel të ngjashëm si dhe në periudhat e monitoruara tetor dhe 19 qershor – 30 shtator. Në të njëjtën kohë, për më shumë se dyfish është zvogëluar përqindja e informacioneve në të cilat janë theksuar burime nga pushteti ekzekutiv krahasuar me muajin paraprak (nëntor). Krahasuar me dhjetorin, përfaqësuesit qeveritar ishin më shpesh të përfaqësuar si burime në informacionet mediatic dhe në periudhën 19 qershor – 30 shtator, ndërsa në tetor pothuajse aspak nuk ishin theksuar si burime.



Në dhjetor gazetat dhe televizionet e monitoruara sërish në mënyrë dominante e kanë përmendur Kuvendin në kontekst të ngjarjeve më të gjëra politike, bojkoti i opozitës të udhëhequr nga LSDM dhe procedura për marrje të mandateve nga deputetët të deputetëve opozitar. Sërish në mënyrë të konsiderueshme më të vogël është informuar konkretisht për debatet dhe argumentet e prezantuara në seancat plenare dhe të komisioneve. Me këtë, opinioni në pjesë shumë të vogël është i informuar për pjesën më të madhe të ngjarjeve në Kuvendin të cilat kanë të bëjnë me temat të cilat i shqyrtojnë deputetët dhe argumentet të cilat prezantohen në seancat në favor ose kundër zgjidhjeve ligjore.

Gazetat shumë më tepër se sa televizionet kanë botuar informacione në të cilat Kuvendi.

## **B. METODOLOGJI E HULUMTIMIT**

Monitorimi i medieve përfshin përcjellje të informacioneve të paraqitura në 10 medie kombëtare në të cilat deputetët dhe Kuvendi. Përcjellja i përfshin tekstet e botuara në gjashtë gazeta ditore nga të cilat katër janë në maqedonisht dhe dy në gjuhën shqipe. Nga kontributet televizive përcillen informacionet e transmetuara në emisionet qendrore informative në katër televizione kombëtare nga të cilat dy janë në gjuhën maqedonase, ndërsa dy janë në gjuhën shqipe. Me monitorimin janë përfshirë mediet vijuese:

### **Gazeta**

- Dnevnik
- Utrinski vesnik
- Veçer
- Sloboden pečat
- Koha
- Lajm

### **Televizione**

- Sitell
- Tellma
- Alsat-M
- RTM2 Programi në gjuhën shqipe

Në mediet e përmendura përcillen dhe analizohen informacionet në të cilat përmenden Kuvendi, deputetët dhe procedura ligjvënese. Me këtë rast, në hulumtimin, si pjesëtarë të opozitës janë llogaritur edhe pjesëtarët e partive opozitare të cilët në zgjedhjet e fundit parlamentare morën mandate, por vendosën të mos i pranojnë. Në çdo tekst veç e veç dhe në çdo kontribut televiziv analizohen elementet kryesore përkatësisht zhanri, fokusi i informacionit, lloji, numri, pala dhe sheshtësia e burimeve

## **V. KONTEKSTI POLITIK**

Në pajtim me Kushtetutën dhe Kodin zgjedhor, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Njëqind e njëzet deputetë zgjedhen në lista proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh, ndërsa tre deputetë zgjedhen nga tre njësi zgjedhore në botën e jashtme. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme maqedonase revolucionare – Partia demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e formon qeverinë, BDI fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë Opsioni qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK). Deputeti i GROM është pjesë e koalicionit në pushtet, ndërsa deputeti




i cili mandatin e morri nga RDK edhe përkundër vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin ju bashkëngjit grupit të deputetëve të BDI. Me këtë tani grupi i deputetëve të BDI numëron 20 deputetë.

Nga fillimi i monitorimit deri në botimin e këtij raporti, deputetët nga koalicioni më i madh të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotuan punën e Kuvendit. Në muajin dhjetor në Kuvendin si opozitarë vepronin dhjetë deputetë, shtatë nga Partia Demokratike shqiptare (PDSH) dhe tre nga koalicioni opozitar i LSDM të cilët vendosën ti pranojnë mandatet. Shumica në Kuvendin në nëntor e filloi procedurën për marrje të mandateve të 31 deputeti opozitar të cilët e bojkotojnë parlamentin. Procedura vazhdoi edhe në muajin dhjetor dhe në momentin e botimit të këtij raporti ende nuk ka përfunduar.

## G. GJETJE NGA MONITORIMI


Ky raport i përfshin informacionet e botuara gazetareske të cilat kanë të bëjnë ose që e prekin punën e Kuvendit në periudhën nga 1 deri 31 dhjetor. Janë analizuar gjithsej 121 tekste dhe kontribute gazetareske të botuara në gazetatat dhe në televizionet. Prej tyre:

- lloj medias: 68 % janë në gazeta, ndërsa 32% në televizione
- gjuhë: 69% janë botuar në mediet në maqedonisht, ndërsa 31% në gjuhën shqipe
- nga tekstet e botuara në mediet e shtypura, 76% janë botuar në gazeta në maqedonisht, ndërsa 24% në gazeta në gjuhën shqipe
- nga kontributet në televizionet, 56% janë të botuara në maqedonisht, ndërsa 44% në gjuhën shqipe



## I. ZHANRI I INFORMACIONEVE

Në dhjetor informacionet gazetareske të cilat kanë të bëjnë me Kuvendin sipas karakteristikave të zhanrit, në pjesë më të madhe, 54%, kanë qenë të strukturuar si raporte, përkatësisht vetëm informojnë për ngjarjet e ndërlidhura me Kuvendin. Kjo është më tepër në raport me nëntorin dhe tetorin, e diç më pak nga periudha e parë e monitoruar (19 qershor/30 shtator) kur janë regjistruara 61% informacione të tilla. Nga tekstet dhe kontributet e monitoruara, 22% janë shkrime, përkatësisht kanë element informativ dhe analitik gjatë raportimit për ngjarjen që është në kuadër të mesatares së deritanishme që nga fillimi i monitorimit të medieeve. Nga informacionet e botuara 19% janë lajme themelore në të cilat ka vetëm informacion të shkurtër nga ngjarja dhe vetëm nga 2% janë intervista dhe analiza, ndërsa 1% komente për ngjarje të caktuara.




## II. FOKUS I TEKSTEVE DHE TË KONTRIBUTEVE


Monitorimi i përmbajtjeve të botuara në mediet tregon se në dhjetor përqindja e informacioneve në të cilat Kuvendi vetëm përmendet është identik si edhe në nëntor përkatësisht është 30%. Kjo është më pak se sa në dy periudhat e para të monitoruara 19 qershor – 30 shtator dhe tetor. Nuk ka ndryshim as në përqindjen e informacioneve në të cilat në të cilat raportohet në përgjithësi me punën e parlamentit, e të cilat në mënyrë qenësore nuk kanë të bëjnë me punën e Kuvendit. Të tilla janë 39% nga informacionet e botuara në dhjetor gjë e cila është identike me nëntorin. Këto informacione në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me punën e Kuvendit dhe raportet midis partive duke mos hyrë në detaje të seancave. Në informacione të tilla në tetor shkojnë 31%, ndërsa në periudhën 19 qershor – 30 shtator 15% të botimeve mediatik në të cilat është përmendur Kuvendi.

Mediet e monitoruara në dhjetor në gjithsej 22% nga përmbajtjet e botuara kanë informuar për debatet kuvendore nga të cilat në 16% nga seanca plenare, ndërsa në 6% nga seancat të komisioneve kuvendore. Më tepër për diskutimet parlamentare mediet e monitoruara informojnë vetëm në periudhën 19 qershor – 30 shtator ndërsa në tetor dhe nëntor kjo përqindje ishte më e vogël.

Për mediet në dhjetor më interesante ishin temat për procedurat për marrje të mandateve të deputetëve opozitar të cilët e bojkotojnë punën e parlamentit dhe diskutimet rreth pakos së ndryshimeve të ligjeve në arsimin, e posaçërisht të ndryshimeve të Ligjit për arsimin e lartë.




Me këtë rast, mund të vërehet se mediet në gjuhën maqedonase në këtë periudhë shumë më tepër kanë botuar informacione në të gjitha kategoritë e monitoruara krahasuar me mediet të cilat botojnë në gjuhën shqipe.



### III. NUMRI DHE PALA E BURIMEVE


Në tekstet dhe kontributet e monitoruara në dhjetor ka rënë përqindja informacioneve në të cilat është theksuar vetëm një burim në 32% që njëkohësisht është niveli më i ulët deri tani që nga fillimi i monitorimit. Me dy burime kanë qenë 28%, ndërsa me tre 13% nga informacionet. Në 17% të informacioneve të monitoruara në dhjetor janë theksuar më tepër se tre burime gjë e cila është më tepër deri tani nga fillimi i monitorimit. Në 9% të përmbajtjeve të botuara në të cilat është përmendur Kuvendi nuk janë theksuar burime.






Në dhjetor pothuajse gjysma e informacioneve të monitoruara burime ishin deputetët (49%). Kjo është për 26% më tepër krahasuar me nëntorin, ndërsa pothuajse identike me tetorin dhe periudhën 19 qershor – 30 shtator. Në 23% të informacioneve si burime janë theksuar parti politike ose përfaqësues të tyre që është për 6% më tepër se sa në nëntor, por për 9% më pak se në tetor kur kjo përqindje arriti vlerë më të lartë në monitorimin e deritanishëm 32%. Në periudhën 19 qershor – 30 shtator partitë ose përfaqësuesit partiak ishin të theksuar si burime në 12% të informacioneve.

Në dhjetor në 9% të informacioneve të botuara si burim janë theksuar përfaqësues të Qeverisë dhe të ministrive, ndërsa vetëm në 8% burime nga institucionet e tjera shtetërore. Në 6% të informacioneve si burime “të tjera” janë theksuar më shpesh diplomatë të huaj, përfaqësues dhe parlamentarë, ndërsa në 4% janë konsultuar analistë.




Në dhjetor në 83% të informacioneve në të cilat burime janë deputetë ata janë theksuar me emër dhe mbiemër. Në 17% deputetët janë anonim, përkatësisht nuk janë të emëruar.



Nëse analizohet sipas asaj se cilit opion politik u takojnë deputetët, të cilët si burim kanë qenë të konsultuar në tekstet dhe kontributet gazetareske, rezulton se mediet në dhjetor kanë publikuar në shumë informacione deri tani në të cilat në të njëjtën kohë janë përfshirë burime edhe nga pushteti edhe nga opozita. Njëkohësisht në dhjetor janë botuar më pak informacione deri tani në të cilat si burim janë theksuar deputetë vetëm nga njëra anë, pushteti ose opozita.




Në 45% të informacioneve janë konsultuar deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita. Në 25% si burime janë theksuar deputetë nga shumica në pushtet, ndërsa në 24% deputetë aktiv ose të zgjedhur nga partitë opozitare të cilët nuk e pranuan mandatat.




#### IV. RUBRIKA

Sipas të dhënave nga monitorimi, në dhjetor 55% të teksteve dhe të kontributeve në të cilat është përfshirë Kuvendi janë paralajmëruar në faqet kryesore të gazetave ose në paralajmërimin e përgjithshëm të lajmeve në ditaret televizive, ndërsa 45% nuk kanë fituar vend të tillë. Në raport me rubrikat, këto informacione më shpesh, në 99% të rasteve, janë botuar në faqet e para të gazetave dhe në pjesët fillestare të gazetave ditore si “Makedonija”, “Politika”, “Aktuelno” ose ngjashëm. Informacionet në të cilat përmendet Kuvendi shumë më rrallë, vetëm në 1% të rasteve, janë botuar në rubrikë tjetër. Në dhjetor asnjë nga informacionet e monitoruara që kanë të bëjnë me shtëpinë ligjvënëse ose në të cilat Kuvendi vetëm përmendet nuk është e botuar në rubrikat të përkushtuara ekonomisë dhe biznesit, ose në rubrikat e kushtuara komenteve dhe kollumnave.



Në përmbajtjet e monitoruara mediatike në tetor, në 82% të teksteve dhe të kontributeve është theksuar, ndërsa në 18% nuk është theksuar autori i përmbajtjes së botuar në të cilat përmendet Kuvendi.





#### D. KONKLUZIONE:

- Mediet në dhjetor i kushtuan vëmendje diç më të madhe debatit dhe argumenteve të prezantuara në seancat kuvendore krahasuar me dy muajt paraprak (nëntor dhe tetor). Më tepër informacione për debatet parlamentare janë botuar vetëm në periudhën 19 qershor – 30 shtator.
- Interesim më të madh te mediet për punën e deputetëve shkaktuan diskutimet rreth procedurat për marrje të mandateve të deputetëve opozitar të cilët e bojkotuan punën e Kuvendit dhe debatet rreth ndryshimeve të Ligjit për arsimin e lartë.
- Në dhjetor është vërejtur deri tani përqindja më e madhe e informacioneve në të cilat si burime njëkohësisht janë theksuar deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita. Përqindja e informacioneve në të cilat janë theksuar burime – deputetë vetëm nga një opion politik është më i vogël që nga fillimi i monitorimit. Me këtë rast në informacionet në të cilat janë të përfshirë deputetë nga pushteti ose nga opozita bije përqindje e njëjtë.
- Në dhjetor sipas përfaqësimit, si burime kryesore në informacionet mediatike të cilat kanë të bëjnë me Kuvendin u kthyen deputetët. Përfaqësimi i tyre është dyfish më e madhe se sa në nëntor, e kjo ndërkaq është në kuadër të mesatares së tetorit dhe të periudhës 19 qershor – 30 shtator. Në dhjetor në vend të dytë sipas përfaqësimit janë burime nga parti politike, ndërsa në vend të tretë janë burime nga pushteti ekzekutiv përkatësisht nga Qeveria dhe ministritë.
- Opinioni në përgjithësi mbetet i informuar në mënyrë të pamjaftueshme nga mediet për ngjarjet në Kuvendin, ligjet të cilat shqyrtohen dhe argumentet të cilat i prezantojnë deputetët në seancat.
- Kuvendi në dhjetor të vitit 2015, sërish shpesh është përmendur në kontekst të situatës më të gjerë politike në shtetin tonë, raportet midis partive, bojkotit të opozitës dhe procedurës në vazhdë e sipër për marrje të mandateve.
- Mediet në gjuhën maqedonase në sasi dukshëm më të madhe kanë raportuar për Kuvendin se sa mediet në gjuhën shqipe. Gazetat njëjloj si në periudhën paraprake në sasi më të madhe informojnë për ngjarje të ndërlidhura me Kuvendin sesa televizionet.



\*\*\*\*\*

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” është i financuar nga Unioni Evropian.

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyre nuk mund të llogaritet se i shfaq pikëpamjet e Unionit Evropian